



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 92-të, të mbajtur më 31.08.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-9360/1 nga 24.11.2022, në lidhje me procedurën e kryer pas shpalljes publike nga ana e Ministrisë ----- për dhënien e lejes në vend gjueti në përdorim me koncesion, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka kompetencë për veprim në rastin në fjalë, për arsye se vlerësoi se parashtruesi i denoncimit nuk ka pasur mundësi të drejtohet për veprim kompetent në organin tjetër gjegjësisht komisioni shtetërorë për ankesa pas prokurimeve publike.

Lënda me numër 12-9360/1 të datës 24.11.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më 24 nëntor 2022, një parashtrues i njohur ka paraqitur denoncim në lidhje me një procedurë të kryer pas një thirrjeje publike të publikuar nga Ministria e ----- i RMV-së për dhënien e lejes në vend gjueti në shfrytëzim me koncesion dhe është formuar lënda me numër 12-9360/1 datë 24.11.2022.

Në denoncim, parashtruesi thekson se Ministria e ----- RMV publikoi thirrje publike për dhënien e lejes në vend gjueti për përdorim me koncesion ne zonën e gjuetisë -----, në lidhje me të cilën thirrja e Shoqërisë së Gjuetisë "-----" nga ----- paraqiti një ofertë për vend gjueti ----- më saktë për vend gjueti -----, ----- dhe -----.

Gjatë procedurës për vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm, oferta e paraqitur nga kompania e përmendur e gjuetisë është refuzuar me arsyetimin se shoqata nuk ka aktivitete të regjistruar, gjë që parashtruesi deklaroi se nuk është e vërtetë dhe se gjatë procedurës për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm Shoqata e Gjuetisë "-- ----- --" nga -----është e dëmtuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arrin në përfundimin se në këtë rast parashtruesi ka pasur mundësinë ligjore, pas ndodhjes së ngjarjeve të shpjeguara në denoncim, t'i drejtohet Komisionit Shtetëror për Ankesat e Prokurimit Publik si autoritet kompetent për trajtimin e këtyre dhe/ose raste të ngjashme brenda një periudhe të caktuar sipas pretendimeve të njëjta.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja konstaton se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë dhe si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar :

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: K.Z

Miratoi: G.T

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Nënkryetar,
Sofka Pejovska Dojçinovska

